



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:107709

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05756826

P.nr.477/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me pjesëmarrjen e praktikantit të kësaj gjykate Vleran Shala-si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.B., nga Prizreni, me numër personal, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.650-11/24 të datës 15.05.2024, pas mbajtjes së seancës publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në prezencën e prokurorit të shtetit – Mehreme Hoxha, të akuzuarit R.B., mbrojtësit të tij av.B.K., nga Prizreni, me dt.28.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R.B., me nofkën “....., nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur me dt.në Prizren, ku edhe jeton në rr.”” nr....., ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 28.03.2024, rreth orës 08:45 min, në hotelin “.....”, i cili gjendet në rr.”Ismail Kryeziu”, i akuzuari R.B., mban në pronësi dhe posedim armë të zjarrit, pa leje të organit kompetent dhe në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-022 për armët, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të bërë nga ana e policisë në hotelin e lartpërmendur, në depon e hotelit janë gjetur të fshehura: një (1) pistoletë e tipit TT, ngjyrë e zezë, një (1) karikator me tetë (8) fishekë të kalibrit 7.62 mm dhe një (1) kuti me dyzet e një (41) fishek të kalibrit 7.62 mm, të cilat më pas janë sekuestruar nga ana e policisë.

Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit të lartë shënuar dhe neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69 të KPRK-së, si neni 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 1.200 € (një mijë e dyqindë euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron që ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur 20 € (njëzet euro) për një ditë burgim, përkatësisht 60 ditë burgim.

Të akuzuarit në pajtim me nenin 366 par.3 të KPRK- së, i konfiskohen: një (1) pistoletë e tipit TT, ngjyrë e zezë, një (1) karikator me tetë (8) fishekë të kalibrit 7.62 mm dhe një (1) kuti me dyzet e një (41) fishek të kalibrit 7.62 mm, mjete të kryerjes së veprës penale dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

I akuzuari R.B., obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 euro, dhe për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën nën numrin PP/II.nr.650-11/24 të datës 15.05.2024, kundër të akuzuarit R.B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa aktakuzës ia ka bashkangjitur edhe marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr.650-11/24, të datës 14.05.2024.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka dëgjuar Prokurorin e Shtetit, mbrojtësin e të akuzuarit, dhe të akuzuarin.

Prokurori i Shtetit Mehreme Hoxha gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes deklaroi se: prokurori i shtetit në bashkëpunim me të pandehurin R.B., dhe mbrojtësen e tij av. Besa Krajku, me dt.14.05.2024, në Prokurorinë Themelore në Prizren kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndër të tjerash në këtë marrëveshje është paraparë edhe dënimi i rekomanduar për veprën penale e cila i vihet në barrë të pandehurit dhe është rekomanduar dënimi me gjobë në lartësi prej 1000 euro deri në 1500 euro, njëherit është propozuar që të konfiskohet mjete të kryerjes së veprës penale dhe atë: një armë zjarri, pistoletë model TT me numër serik J – 23.....9888, M – 57. J2.1 një karikator me 8 fishekë dhe një pako me 41 fishekë. Marrëveshja është lidhur pa ndonjë presion dhe me vullnetin e palëve.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.B., av.B.K., gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes deklaroi se: pas konsultimit të mjaftueshëm me të pandehurin R.B., dhe pasi që të njëjtit i janë sqaruar favorët e pranimin të fajësisë i njëjti me vullnet, pa presion është pajtuar që të negociojë në Prokurori për pranimin e fajësisë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Dënimi i rekomanduar sipas kësaj marrëveshje është dënim me gjobë në lartësi prej 1000 deri në 1500 euro, andaj duke patur parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pendimin e tij si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, propozoj që ti shqiptohet minimumi i gjobës së rekomanduar.

I akuzuari R.B., pajtohet me fjalët e mbrojtjes së tij dhe nuk ka asgjë tjetër që të shtojë.

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, mbrojtësit të të akuzuarit si dhe vet të akuzuarit, lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, konstatojë se i akuzuari R.B., e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij av.Besa Krajku, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar, ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 248 par.1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit R.B., formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi

dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka dëgjuar deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimin e propozuar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë duke marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit qysh në fazat e hershme të procedurës sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, pendesën e shprehur për veprimet e kryera, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë veprime kundërligjore. Kështu, duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale, të cilat i posedon i akuzuari dhe sipas bindjes së gjykatës dënimi i tillë do të ndikojë mjaftueshëm tek i akuzuari dhe në rrethinën ku ai jeton që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla inkriminuese.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 449 dhe 452 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 36 par.3 pika 3.1 të ligjit nr. 08/L-109.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI
PENAL
2024:107709
P.nr.477/2024, të dt.28.05.2024**

**Procesmbajtës
Vleran Shala**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vendimit mbi dënimin dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.